



QYTETI I CERVIGNANO DEL FRIULI
BIBLIOTEKA
 Qendra e Sistemit
 te Sherbimit Bibliotekar te Friulit te Ulet



BIBLIOTEKA

Biblioteka është e hapur për të gjithë dhe afrohet falas: keshillimi në bibliotekë dhe librave, enciklopedite, gazetat e revistat, huaja e volumeve dhe revistave, mundësi për të lundruar në internet. Personeli i bibliotekës është gjithmone në dispozicion për të shpjeguar shërbimet e ndryshme, për të ndihmuar përdoruesin për të orientuar në bibliotekë, për të bërë kërkime, për të hyrë në katalogun online dhe në internet.

RREGJISTRIMI

Rregjistrimi është i nevojshëm për të shfrytëzuar shërbimet e bibliotekës dhe është falas: është e mjaftueshme të prezantosh një dokument dhe të plotësosh një modul rregjistrimi për të patur tështerën. Në rastin e një minoreni moduli duhet të jetë i firmosur nga njëri prej prindërve (ose nga kush ushtron pushtetin atëror) që duhet të dijë se çfarë mundet o nuk mund të bëhet në bibliotekë. Në momentin e rregjistrimit është e mundur të rregjistrohesh edhe në shërbimin e internetit: për të bërë, në rastin e minoreneve, prinderit duhet të japin pranësinë me shkrim mbasi të kenë lexuar rregulloren e përdorimit.

SEKSIONET

Biblioteka është e ndarë në seksione të ndryshme.

Ne katin perdhës:

SEKSIONI I FEMIJEVE e ndarë në Sallen e vogëlusheve dedikuar të vegjelve nga moshë 0 deri 7 vjeç dhe në Sallen e femijeve me libra dhe revista për vogëlushe dhe femije nga moshë 8 deri në 14 vjeç.

Ne katin e pare:

SALLA E KESHILLIMIT e **LEXIMIT** ku është e mundur të keshillosh të gjithë veprat, edhe ato që nuk japin hua (enciklopedite, fjaloret, vepra të ralla ose me vlerë të veçantë).

Vende të tjera për të lexuar dhe për të studiuar janë megjithatë të përhapura në të gjithë bibliotekën.

SALLA ME RAFTE TË HAPURA ku përdoruesi mundet, edhe me ndihmën e sistemit të shenjave, të marrë lirish librat nga raftet në baze të interesave të tij.

SALLA MULTIMEDIALE ku janë të pranishme 6 vende për hyrjen falas në internet dhe disiplinuar nga rregulloret e posaçme e ku janë të vendosur edhe librat e Informatikës, Muzikës e Kinemasë dhe CD-të e DVD-të.

EMEROTECA ku gjenden të gjithë periodikët në të cilët biblioteka është e abonuar dhe gazetat e përditshme.

SEKSIONI I VENDIT i përbërë nga më shumë se 3.000 dokumenta – të blera nga biblioteka ose të dhuruara nga privatet o institucionet – me interes lokal dhe krahinorë.

NJOFTIME TË NEVOJSHME PËR TË GJITHË

Për të mos sjellur shqetësim kujt po studion ose po lexon gazetën është mirë që të kujtohet që të vejë në heshtje ose të fikë telefonin celular dhe të mbajë një ton zeri të duhur.

Në bibliotekë ka edhe dy hapësira ku janë të vendosura dy shpërndareshë pijesh dhe snack: është mirë të bësh konsumimin afër këtyre, që t'ju shmangësh gjerave të padëshirueshme dhe dëmëve.

SHERBIMET

KESHILLIMI: është e mundur të shfrytëzosh nga sallat e keshillimit e leximit që gjenden si në katin perdhës (**SALLA E FEMIJEVE**) e si në katin e parë, ku është e mundur të përdorësh enciklopedite dhe fjaloret dhe kompjuterin tuaj portativ .

HUAJA: duke prezantuar tështerën mund të merren hua për një muaj deri në 5 libra. Huaja e një libri mund të përsëritet duke ardhur personalisht në bibliotekë o duke telefonuar ose dërguar një mail. Është edhe e mundur të prenotosh atë çfarë të intereson direkt nga katalogu online dhe pastaj të kalosh në bibliotekë për të tërhequr. Mund të merren në hua për një javë edhe revistat, përveç dy numrave të fundit.

Nepërmjet huasë ndërbibliotekare është e mundur të ju kërkosh bibliotekave të tjera një libër që biblioteka e Cervignanos nuk e ka.

Në bibliotekë gjenden të rejtat e librarisë dhe klasikët, romanet policorë, aventurorë, fantazi e fantastico-shkencorë, histori horror e dashurie, romanet e historisë e humoristike, libra të shkencës, të mjekësisë, të historisë, të gjeografisë, udhëzues turistik. Ka edhe një seksion të vogël librash në gjuhë origjinale.

INTERNET: në sallën multimediale janë të gatshëm më hyrje falas në internet 6 kompjuter që mund të jenë të përdorshëm për 30 minuta (më mundësi zgjatje kohe). Interneti në bibliotekë garanton hyrjen e lirë dhe pa limit në njohjen, në mendimin, në kulturën dhe në informatat. Për bibliotekë nuk ka një kontroll të burimeve në dispozicion në rrjetë, as njohjen e plotë të çfarë interneti mund të vendosë në çdo moment në dispozicion të publikut: po ajo vetë, domethënë, nuk është përgjegjëse për përmbajtjet e afuara .

Interneti në bibliotekë duhet të përdoret me koherencë me funksionet dhe objektivet themelore të saj, kështu si janë të caktuara nga Rregullorja. Mundesh, domethënë, të hysh në internet për të bërë kërkime, për të marrë ose për të dërguar postën elektronike, por jo për motive tregtare, për të bërë lojra online ose për të chatuar (chatt).

FOTOKOPJE DHE STAMPA: mund të bëhen më pagesë (15 centim për fletë) vetëm fotocopje të librave të pranishëm në bibliotekë – në respekt të limitit të venë nga ligji - ose stampa nga interneti .

SHERBIMI BIBLIOTEKAR I FRIULIT TË ULET: biblioteka e Cervignanos së Friulit është qendra e sistemit të Sherbimit bibliotekar të Friulit të Ulet. Sistem, që realizon aktivitete në bashkëpunim dhe afron shërbime të koordinuara, ku bëjnë pjesë bibliotekat e Komunave të Aiello del Friuli, Aquileia, Campolongo Tapogliano, Fiumicello, San Vito al Torre, Terzo di Aquileia, Villa Vicentina, Visco.

ORARI I HAPJES

Nga e hënës deri të shtunës në mëngjes nga 09.30 deri në 12.00
 të hënës, të mërkurës, të enjtës e të premtes mbasditë nga 15.30 deri në 19.00.

ADRESA DHE NUMRAT TELEFONIKË:

via Trieste, 33 - Cervignano del Friuli
 tel 0431-388540 fax 0431-388910 e mail: biblioteca@com-cervignano-del-friuli-regione.fvg.it
 sito internet: www.cervignanodelfriuli.net
 katalogu online i bibliotekës: www.infoteca.it/cervignano/homepage.htm
 katalogu online i sistemit bibliotekar: www.sbbf.it